



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 2285/2 Prot.
Datë: 28.12.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 28. 12. 2020

VENDIM

Nr. 60, datë 28. 12. 2020

**PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT DOKTORATË NË SHKENCAT
E SHËNDETIT**


Në mbështetje të nenit 49, nenit 77 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr. 41, datë 24. 01. 2018 "Për elementët e programve të studimit të ofruara nga ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, si dhe shkresës nr. 2122 prot, datë 14. 12. 2020 të Rektorit të UV-së, në mbledhjen e datës 28. 12. 2020 Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të ri të studimit në ciklin e tretë të studimeve në Doktoratë në Shkencat e Shëndetit në Fakultetin e Shëndetit, miratuar me vendim Senati Akademik nr. 109, datë 07. 12. 2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. ERVIS MOÇKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Nr. 222 Prot.

Vlorë më, 14. 12. 2020

Lënda: Përcjellje propozimi për program të studimi "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit"

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

I nderuar Kryetar i BA,
Të nderuar Anëtarë,

Referuar Udhëzimin nr. 1, datë 14 .01. 2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", bashkëlidhur po Ju përcjellim propozimin e Dekanit të Fakultetit të Shëndetit për hapjen e programit të ri të studimit "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit" me shkresë nr. 264/1 prot, datë 26. 11 2020, si dhe relacionin e Zv. Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional me shkresën nr. 1964/3 prot, datë 14. 12. 2020 miratuar dhe me vendim Senati Akademik nr. 109, datë 07. 12. 2020 "Për miratimin e programit të ri të studimit Doktoratë në Shkencat e Shëndetit", për miratim të mëtejshëm pranë Bordit të Administrimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

REKTOR
Prof. **Dr. Roland ZISI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 1964/23 Prot.

Vlorë, më 14/12/2020

Lënda: Relacion mbi programin e ri të studimit me emërtim "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit".

REKTORI
PROF. DR. ROLAND ZISI

I nderuar z. Rektor,

Me shkresën Prot. 1964 Nr. Datë 26/11/2020, jemi informuar mbi kërkesën e Fakultetit të Shëndetit për hapjen e një program të ri me emërtim "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit". Ky program do ofrohet nga Departamenti i Kujdesit Shëndetsor, Fakulteti i Shëndetit. Ky program ka për mision të pregatisë gjeneratën e ardhshme të akademikëve dhe profesionistëve si kërkues të mirë-trajnuar në fushën e shëndetit, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Vazhdueshme (OZHQ) 3 dhe 4. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e profesionistëve të shëndetit të nivelit Doktoratë për ti ushtruar detyrat si akademikë, kërkues dhe menaxhues shëndetësorë në standartet më të larta bashkëkohore. Paralelisht, qëllimi përfundimtar i këtij programi studimi është shndërrimi i Fakultetit të Shëndetit në UV në liderin rajonal të kërkimit shkencor në shëndetësi. Ky program do të ofroj 180 kredite. Studentët doktorantë do të kenë mundësinë të zhvillojnë studimet e tyre me kohë të plotë (3 vite) ose me kohë të pjesshme (5 vite).

Justifikimi i programit

- Baza ligjore për hapjen e këtij programi të ri studimi është e justifikuar në raportin e aplikimit;
- Nevoja për hapjen e këtij programi të ri të studimi është e justifikuar në raportin e aplikimit;
- Është prezantuar vendimi i hapjes së njësisë kryesore;
- Është prezantuar vendimi i akreditimit institucional;
- Është saktësuar qartë emërtimi i diplomës, kohezgjatja, lloji i studimit, forma e studimit dhe kreditet që fitohen;
- Janë përcaktuar objektivat e studimeve dhe punësimi i studenteve që përfundojnë këto studime;
- Është zhvilluar SWAT analysis për këtë program të ri studimi;
- Kriteret e pranimit janë prezantuar qartë në formularin e aplikimit;
- Fusha e studimeve paraardhëse në rastet e programeve është prezantuar qartë;
- Kuotat e kërkuara janë prezantuar;
- Është bashkëngjitur programi i studimeve dhe plani mësimor me kredite sipas ECTS;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV. REKTORI PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

- Është bashkëngjitur lista e stafit akademik me tituj, që do të mbulojnë ngarkesën mësimore;
- Është prezantuar infrastruktura akademike në funksion të programit (numëri dhe sipërfaqet e auditorëve, laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale, biblioteka, numëri i titujve etj.);
- Është zhvilluar analizë e tregut të punës;
- Janë prezantuar marrëveshjet me operatorë privatë/institucione publike të tjera brenda dhe jashtë vendit;

Në bazë të të gjitha këtyre më lart mendojmë se propozimi për hapjen e programit të ri me emërtim "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit" i përshtatet strategjisë së Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali", misionit të Njesisë Kryesore dhe asaj Bazë ndërsa dokumentacioni i prezantuar është i plotë. Mbi të gjitha këto, propozojmë që kjo kërkesë të përcillet për miratim në Bordin e Administrimit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Zv. Rektor

PhD Enkelejd Mëhilli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEKANI

1866

26.11

20111120
13:17

Nr. 264/1 prot.

Vlorë, më 26.11.2020

Lënda: Shkresë përcjellëse për projekt propozimin për hapjen e programit "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit.

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTORIT TË UNIVERSITETIT

Prof.Dr.Roland Zisi

ADMINISTRATORES SË UNIVERSITETIT

Mirela Duka

I nderuar Z.Rektor,

E nderuar Znj.Administratore,


Bashkangjitur po Ju dërgoj projekt - propozimin e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor për hapjen e programit "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit", për ndjekjen e procedurave të mëtejshme.

Duke Ju falenderuar për baskëpunimin,

DEKANIA E FAKULTETIT TË SHËNDETIT

Prof.asoc.Aurela Saliaj

AS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Nr. 264 prot.

Vlorë, më 25 . 11 . 2020

VENDIM

I DEPARTAMENTIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Nr.18, datë 25-11-2020

për

“HAPJEN E PROGRAMIT “DOKTORATË NË SHKENCAT E SHËNDETIT”,


Departamenti i Kujdesit Shëndetësor – FSH i mbledhur sot më datë 25.11.2020 shqyrtoi programin e propozuar nga grupi i punës i Departamentit të Kujdesit Shëndetësor, (i ngritur me Urdhër të Drejtueses së Departamentit të Kujdesit Shëndetësor me Nr. 96 Prot., dt 05.04.2019), në Doktoratë në Shkencat e Shëndetit.

Ky propozim mbështetet në:

- Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 70 / pika 4 “Ciklet dhe programet e studimeve”,
- Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve: Diplomë universitare për gradë shkencore (niveli 8 i KSHK)
- Udhëzimin Nr.41, datë 24.01.2020 të MASH “Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”,

Propozimi është një zbatim konkret i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 3 (Për shëndet të mirë dhe Mirëqenie), OZHQ 4 (Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe mësim për të gjithë) e OZHQ 8 (Punësim i denjë dhe rritje ekonomike); si dhe detyrave që shtrohen nga Agjensia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për universitete sa më cilësore, të orientuara drejt kërkimit shkencor.

Qëllimi kryesor i programit Doktoratë në Shkencat e Shëndetit është shndërrimi i Fakultetit të Shëndetit në UV në liderin rajonal të kërkimit shkencor në shëndetësi. Përgatitja e profesionistëve të shëndetit të nivelit Doktoratë për ti ushtruar detyrat si akademikë,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

kërkues dhe menaxhues shëndetësorë në standartet më të larta bashkëkohore.

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor vlerësoi se:

Propozimi për hapjen e Doktoratë në Shkencat e Shëndetit ishte mbështetur në plotësimin e kritereve strukturore, organizative dhe ato për personelin akademik, si dhe në bashkëpunimin institucional me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë; Hellenic Mediterranean University, Greqi dhe Fh Gesundheit - Tirol Kliniken GmbH and Private University for Health Sciences, Medical Informatics and Technology, Austri.


Në përfundim Departamenti i Kujdesit Shëndetësor

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit të grupit të punës për hapjen e programit Doktoratë në Shkencat e Shëndetit.
2. Përcjelljen e programit të propozuar tek Dekania e FSH për ndjekjen e procedurave të mëtejshme.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Dr. Ela Peto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

PROJEKT-PROPOZIM PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
DOKTORATURË në SHKENCAT E SHËNDETIT


1. Institucioni/IAL	Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë
2. Aplikimi	a. Program i ri
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje a. Shkruani emrin e plotë të programit	Doktoratë në Shkencat e Shëndetit
4. Semestri dhe viti akademik i hapjes	Viti akademik 2020-2021, semestri Pranverë 2021
5. Të dhënat për aktin e akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.	Akreditimi i UV: Vendim i ASCAL Nr. 71, dt. 21.09.2017 Hapja e FSHP: Urdhër i MAS nr. 398, dt. 10.08.2011
6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik	Vendim Nr. prot., dt i Senatit Akademik të UV
Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit	Vendimi Nr. prot., dt. i Bordit të Administrimit të UV
7. Nëse është një program i përbashkët	
8. Programi ofrohet nga/në:	Departamenti i Kujdesit Shëndetësor Fakulteti i Shëndetit Kampusi/godina D
9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit	Emër, mbiemër: Aurela Saliaj Pozicioni në IAL: Dekane e FSH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	Tel: +355 69 6191305 E-mail: aurela.dai@univlora.edu.al
10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standarteve akademike dhe infrastrukturore.	Shkresa e rektorit të UV Nr.
11. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.	



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE/RIORGANIZIM

1) Të dhëna mbi programin e studimit


Misioni: Programi studimor Doktoratë në “Shkencat e Shëndetit” ka për mision të pregatisë gjeneratën e ardhshme të akademikëve dhe profesionistëve si kërkues të mirë-trajnuar në fushën e shëndetit, në përputhje OZHQ 3 dhe 4.

Qëllimi: Shndërrimi i Fakultetit të Shëndetit në UV në liderin rajonal të kërkimit shkencor në shëndetësi. Pregatitja e profesionistëve të shëndetit të nivelit Doktoratë për ti ushtruar detyrat si akademikë, kërkues dhe menaxhues shëndetësorë në standartet më të larta bashkëkohore.

Objektivat:

- Zhvillimi i kompetencave kërkimore dhe akademike të studentëve, të bazuar në evidenca klinike.
- Zhvillimi i aftësive të studentëve për integrimin e mësimdhënies dhe praktikës klinike, të bazuar në evidenca kërkimore.
- Personalizimi i programit kërkimor sipas interesave specifike të çdo studenti.
- Aftësimi i studentëve për një analizë kritike të kërkimit në fushën e shëndetit.
- Formimi i shprehive të studentëve për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe për të sugjeruar rekomandime për ndërhyrje në sistem.
- Zhvillimi i aftësive të studentëve për publikimin e rezultateve kërkimore dhe organizimin e aktiviteteve shkencore.
- Kontribuimi në rritjen e kapaciteteve shëndetsore komunitare.
- Akomodimi i një game të gjerë profesioneve që duan të kontribuojnë si kërkues në fushën e shëndetit.

Lloji i programit	Doktoratë
Kohëzgjatja	3-5 vjet
Numri i krediteve	180 kredite
Njësia bazë/njësia kryesore ofruese e programit të studimit	Departamenti i Kujdesit Shëndetësor / Fakulteti i Shëndetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes/riorganizimit të programit

Baza ligjore e kërkesës për hapjen e Programit Doktoratë në "Shkencat e Shëndetit"

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor - FSH propozon hapjen e Programit Doktoratë në "Shkencat e Shëndetit", duke u mbështetur në:

- Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 70 / pika 4 "Ciklet dhe programet e studimeve",
- Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve: Diplomë universitare për gradë shkencore (niveli 8 i KSHK)
- Udhëzimin Nr.41, datë 24.01.2020 të MASH "Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë",

Nevoja për hapjen e Programit Doktoratë në "Shkencat e Shëndetit"

Drejtimi kryesor në të cilin synon të zhvillohet arsimi i lartë, është kërkesa për universitete sa më cilësore, të orientuara drejt kërkimit shkencor (<http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab1>), dhe niveli më i lartë i kërkimit shkencor zhvillohet pikërisht në ciklin e tretë të studimeve. Si mësimdhënia, si zhvillimi profesional në fushën e shëndetit kanë nevojë të aplikohen mbi bazën e evidencave shkencore, ndaj është shumë e rëndësishme që si stafet akademike, si personeli shëndetësor të kenë masivisht formom doktoral. Aktualisht numri i profesionistëve të shëndetit në rajonin e jug-perëndimit (zona nën administrimin e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë) me formim doktoral është jashtëzakonisht minimal: vetëm 1 Doktor Shkencash në Spitalin e Vlorës dhe 5 në Spitalin e Fierit. Ndërkohë që në Shërbimin parësor kërkuesit shkencorë mungojnë tërësisht. Numri i pedagogëve me gradë shkencore është gjithashtu i limituar: në 2 universitetet e Jugut (Vlorë, Gjirokastrë) nga 46 personel akademik në fushën e shëndetit vetëm 16 janë me grada shkencore dhe 4 janë doktorata në proces. Pjesa tjetër prej 26 asistent-lektorësh nuk kanë diploma të ciklit të tretë të studimeve. Ata sigurisht angazhohen në veprimtaritë kërkimore-shkencore, të planifikuara prej departamenteve, por nuk kanë formim të mirëfilltë si kërkues.

Risia që sjell kjo nismë, problematikat që ajo adreson për vet IAL-në dhe nevoja që përmbush në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Hapja e Programit Doktoratë në "Shkencat e Shëndetit" në Universitetin e Vlorës:

- Do ta ngrinte në standartet më të larta kërkimin shkencor në fushën e shëndetit në rajonin e Jugut, duke e promovuar Fakultetin e Shëndetit dhe Universitetin e Vlorës si Lider Rajonal në Kërkim Shkencor.
- do të rriste kapacitetet kërkimore të stafit akademik dhe personelit shëndetësor rajonal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

- do të kontribuonte që Fakulteti i Shëndetit të kishte një staf akademik infermieror të kualiteteve më të larta,
- do të ishte një mundësi për të siguruar staf akademik mjekësor të qëndrueshëm, në kushtet e mungesave për këtë kategori akademikësh në institucionin tonë. Ofrimi i kualifikimit daktoral do të ishte një mundësi më tepër për të parandaluar emigrimin e tyre.
- do të niste standartet e ofrimit të kujdesit shëndetësor nëpërmjet integritetit të njohurive shkencore dhe të vendim-marrjes së bazuar në evidenca klinike.

Analiza SWOT e aplikimit për hapje/organizim programi.

Strengths

- Formimi i kërkuesve shkencorë në ciklin e tretë të studimeve, (pasi ka mbi 10 vjet që formon kërkues të ciklit të dytë të studimeve - Master Shkencor në Shkenca Infermiore) është në vazhden e traditës më të mirë akademike të Fakultetit të Shëndetit.
- Programe të konsoliduara akademike për përgatitjen e kërkuesve të rinj, të asistuar nga pedagogët dhe literatura e UM.
- Traditë e shkëlqyer e temave të diplomës në Master Shkencor: studime analitike, me leje kërkimore nga institucionet shëndetësore, me përpunime statistikore të plota, me procedura serioze vlerësimi në formate të paracaktuara – asgjë më pak nga formatet e Dizertacioneve (<https://univlora.edu.al/master-shkencor-ne-shkenca-infermiore/>). Një pjesë e tyre janë publikuar në revista dhe konferenca prestigjioze dhe në bienalet e FSH, të organizuar posaçërisht me referimet e këtyre punimeve shkencore.
- Fakulteti i Shëndetit ka drejtime kërkimore të përcaktuara dhe vazhdimësi në projekte fizibiliteti specifike, për të cilat ka marr financime nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare:

"Kurbat e rritjes – mënyra bashkëkohore e verësimit të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve" (2006) - financuar nga MASH. 'Kërkimi shkencor – pjesë e reformës së arsimit të lartë', UT "Ismail Qemali" Vlorë.

"Zhvillimi psiko-motor i fëmijëve parashkollorë të qytetit të Vlorës – niveli krahasues dhe faktorët ndikues" – programi 'Për kërkim fundamental dhe ekselencë' (2011) - financuar nga MASH.

"Psikometria në moshat pediatrike" (2020) – financuar nga UV.

"European Accredited Curriculum on Tobacco Treatment-2020" EPACTT-2020 në kuadër të thirrjes së Pfizer "Global Medical Grants". Projekti i fituar financohet nga Pfizer Inc. Nr. kontrate 60290145.

"Duhanpirja te te rinjte. Implementimi i nderhyrjeve parandaluese dhe trajnuese" (2020) - financuar nga UV.

"Self-care level among people with type 2 diabetes in the city of Vlore, Albania - implications for primary health care" (2019) – financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation SDC.

"Parandalimi dhe menaxhimi i sëmundjeve kronike, hartimi i një modeli të vlefshëm për praktiken klinike në shërbimin shëndetësor Paresor në Shqipëri" (2020) - financuar nga UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

- FSH organizon bienale me prezantimin e kërkimeve shkencore në vite të punimeve të diplomës nga studentët e Masterit Shkencor, në nivel konference, të akredituar nga QKEV.
- Struktura akademike dhe administrative, e ngritur për programin master i shkencave do të shërbejë edhe për programin e Doktoratës.

Weaknesses

- Numri ende i ulët i pedagogëve të kategorisë Profesor, të punësuar me kohë të plotë në Fakultetin e Shëndetit. Kjo dobësi do të tejkalohet nëpërmjet angazhimit me kohë të pjesshme (visiting professors) të pedagogëve të tjerë nga tre universitetet mbështetëse dhe duke mbajtur një numër të ulët kuotash pranimi, deri në rritjen e kapaciteteve të brendshme.

Opportunities

- Bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë, që ka një përvojë shumëvjeçare në formimin e doktorantëve dhe ofron praktikisht standartin më të lartë në këtë fushë në Republikën e Shqipërisë, do tu mundësojë studentëve *udhëheqje shkencore* prej pedagogëve të Departamentit të Shëndetit Publik dhe *mbledhjen e të dhënave kërkimore* në QSUT.
- Bashkëpunimi me dy Universitete të BE do tu ofrojë studentëve tanë *bashkëudhëheqje* prej stafit akademik në këto IAL dhe zhvillim të një pjese të procesit kërkimor pranë këture institucioneve: *akses në bibliotekën online* të Hellenic Mediterranean University dhe *mbledhjen e të dhënave kërkimore* pranë institucioneve shëndetësore me të cilat këto universitete bashkëpunojnë gjatë zhvillimit të praktikës klinike tek to (Fh Gesundheit - Tirol Kliniken GmbH and Private University for Health Sciences, Medical Informatics and Technology – Austri dhe Universiteti i Mjekësisë - Tiranë).

Threats

- Tarifa e lartë e shkollimit mund të jetë një kërcënim i mundshëm për pjesëmarrjen e studentëve në këtë program. Por kjo do të mund të tejkalohet nëpërmjet dhënies së bursave të pjesshme apo aplikimit për financim nga palët e treta dhe programe kombëtare e ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

- 2) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët.

Kriteret e pranimit në programin e studimit.
Në programin mësimor Programit Doktoratë në "Shkencat e Shëndetit", kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë personat që: ▪ Zotërojnë diploma të ciklit të parë dhe të dytë (ose diploma të integruara) të fushës së shëndetit me mesatare ≥ 8.00; dhe/ose zotërojnë diploma të ciklit të tretë të studimeve (specializime afatgjata) pavarësisht mesatares. ▪ Zotërojnë diplomë të nivelit C1 në njërën nga 5 gjuhët e BE (vërtetuar me teste ndërkombëtare), të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR; dhe/ose kanë një diplomë të marr në njërën nga këto 5 gjuhë. ▪ Janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij cikli studimesh. ▪ Kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paafësitë që shfaqin. ▪ Renditja e kandidatëve do të bëhet në varësi të kriterëve që do të përcaktojë Departamenti i Kujdesit Shëndetësor dhe Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore 'Doktor'.
Fusha e studimeve paraardhëse në rastet e programeve.
Programe të fushës së shëndetit: Mjekësi, Infermieri, Farmaci, Stomatologji, Fizioterapi, Logopedi, Teknik laborator, Teknik radiolog, Psikologji, Punë sociale.
Numri maksimal i studentëve që do të pranohen.
6 kuota brenda vendit + 2 kuota nga trojet
Tarifa e studimit.
200 000 L
Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e bursave nëse ka).
Mbështeten me bursë studentët e familjeve me të ardhura të pakta ekonomike.
Kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta.
Shqiptarë nga trojet – 2 kuota



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

3) Plani mësimor/ Kurrikula e programit të studimit

Numri total i krediteve	180 kredite
Pasqyrë analitike e kurrikulës dhe krediteve si më poshtë:	
<i>Seminare / trajnime, të ofruara nga FSH</i> ▪ Metodat e kërkimit. ▪ Biostatistikë. ▪ Metodikë mësimdhënieje ▪ Prezantim projektesh klinike	30 kredite
Zhvillim profesional në zonat që përputhen me interesin profesional të studentit – <i>Praktikë profesionale.</i> (Përjashtohet personeli shëndetësor që punon në institucione shëndetësore.)	30 kredite
<i>Pjesëmarrje në aktivitetet e ofruara nga FSH</i> 1. Konferenca shkencore të FSH 2. Projekte kërkimore të departamenteve të FSH 3. Mësimdhënie në FSH, në nivelin Asistent / lektor	30 kredite
<i>Aktiviteteme pjesëmarrje individuale:</i> 1. Konferenca të fushës së Shëndetit/ Dizertacionit 2. Artikuj (autor/bashkëautor) të fushës së Shëndetit / Dizertacionit 3. Projekte kombëtare/ndërkombëtare të fushës së Shëndetit	30 kredite
Kërkim shkencor individual për <i>Dizertacion.</i>	60 kredite




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

4) Personeli akademik dhe ndihmës akademik

Numri i personelit akademik në njësinë bazë	11 pedagogë me kohë të plotë
Numri i personelit akademik që i dedikohet programit të studimit (personel me kohë të plotë/pjesëshme)	7 pedagogë me kohë të plotë 7 pedagogë me kohë të pjesëshme
Numri i personelit akademik të përfshirë përgjegjës për lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesëshme)	7 pedagogë të kategorisë Profesor do të jenë pjesë e Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore 'Doktor' (neni 22 / pika 6 e Statutit të UV)
CV e shkurtuara të personelit akademik që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore)	Aurela Saliq (koordinatori e programit të Doktoratës) <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Titulli shkencor:</i> Professore e asocijuar <i>Grada shkencore:</i> Doktore e Shkencave në Pediatri <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Pediatri, Shëndet Publik
	Yllka Stramarko <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Titulli shkencor:</i> Profesor Doktor <i>Grada shkencore:</i> Doktore e Shkencave në Shëndet Publik <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Pediatri, Shëndet Publik
	Vitori Hasani <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Titulli shkencor:</i> Professore e asocijuar <i>Grada shkencore:</i> Doktore e Shkencave në Shëndet Publik <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Mjeke higjieniste, Shëndet Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR


	Kozeta Hyso <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Titulli shkencor:</i> Professore e asocijuar <i>Grada shkencore:</i> Doktore e Shkencave në Gjuhë angleze <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Gjuhë dhe letërsi angleze
	Evridiki Patelarou <i>Titulli shkencor:</i> Profesor Doktor <i>Grada shkencore:</i> Doktor i Shkencave në Epidemiologji <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Department of Nursing, School of Health Sciences of the Hellenic Mediterranean University</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Epidemiologji, Shëndet Publik
	Athina Patelarou <i>Titulli shkencor:</i> Professore e asocijuar <i>Grada shkencore:</i> Doktor i Shkencave në Evidence-Based Nursing Practice <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Department of Nursing, School of Health Sciences of the Hellenic Mediterranean University</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Evidence based Nursing, healthcare quality and patient safety in the hospital environment
	Maria Bastaki <i>Titulli shkencor:</i> Professore e asocijuar <i>Grada shkencore:</i> Doktor i Shkencave në Infermieri Klinike <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Department of Nursing, School of Health Sciences of the Hellenic Mediterranean University</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermieri Klinike
	Gene Burazeri <i>Kategoria:</i> Profesor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR


	<i>Titulli shkencor:</i> Profesor Doktor <i>Grada shkencore:</i> Doktor i Shkencave në Shëndet Publik <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti i Mjekësisë në Tiranë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Shëndet Publik
	Ariel Çomo <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Titulli shkencor:</i> Profesor Doktor <i>Grada shkencore:</i> Doktor i Shkencave në Shëndet Publik <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti i Mjekësisë në Tiranë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Psikiatri
	Genta Qirjako <i>Kategoria:</i> Profesor <i>Titulli shkencor:</i> Profesor Doktor <i>Grada shkencore:</i> Doktor i Shkencave në Shëndet Publik <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti i Mjekësisë në Tiranë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Shëndet Publik
	Enkeleint A. Mechili <i>Kategoria:</i> Lektor <i>Grada shkencore:</i> PhD në BE - Politika Shëndetësore <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Ekonomi shëndeti, Politika Shëndetësore, Shëndet Publik
	Gjergji Semini <i>Kategoria:</i> Lektor <i>Grada shkencore:</i> PhD në BE - Urologji <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Kirurgji, Urologji



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	Juliana Xhindoli <i>Kategoria:</i> Lektor <i>Grada shkencore:</i> PhD në BE – Shëndet Publik <i>Institucioni parësor i punës:</i> <u>Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë</u> <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermieri, Shëndet Publik
	Nertila Podgorica <i>Kategoria:</i> Lektor <i>Grada shkencore:</i> PhD në BE – Infermieri dhe Shëndet Publik <i>Institucioni parësor i punës:</i> Fh Gesundheit - Tirol Kliniken GmbH and Private <u>University for Health Sciences. Medical Informatics and Technology</u> – Austri. <i>Fusha e ekspertizës:</i> Infermieri, Shëndet Publik
Numri i personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit.	1 staf ndihmës-akademik (Sekretarja e Doktoratës)
Nëse programi i propozuar është interdisiplinor, identifikoni personelin akademik që vjen nga departamente apo fakultete të tjera	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

e) Infrastruktura akademike në funksion të programit


Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve	Fakulteti i Shëndetit Publik ka në dispozicion të 1000 studentëve të tij rreth 3200 m² sipërfaqe, që shfrytëzohet në 2 fasha orare. Orët teorike të programit studimor Doktoratë në Shkencat e Shëndetit do të kryhen në ambjentet e Godinës D të Universitetit 'Ismail Qemali' Fakulteti i Shëndetit Publik. Në dispozicion të formimit teorik të studentëve të këtij programi studimor janë: ☛ 2 klasa seminaresh (kapaciteti 25-30 poste) ☛ 1 sallë takimesh për prezantime në dërrasë interaktive (kapaciteti 15 poste) ☛ 1 sallë konferencash për prezantimin e dizertacioneve (kapaciteti 200 poste) Paketa e leksioneve do të përcillet online si materiale audio e video të regjistruara, në platformat elektronike të mësimdhënies ose në adresat zyrtare të studentëve të UV: @univlora.edu.al.
Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale.	Fakulteti i Shëndetit disponon veç laboratorëve didaktikë edhe një laborator biokimik-mikrobiologjik të dedikuar për mbështetjen e kërkimeve shkencore në fushën e shëndetit. Laboratori është i mirëpajisur me aparaturë bashkëkohore dhe me personel të licencuar në dispozicion (mjekë laborantë biokimistë, mjekë mikrobiologje, laborante). Fakulteti i Shëndetit ka marrveshje institucionale për zhvillimn e praktikës klinike për studentët e vet dhe mbledhjen e të dhënave kërkimore në fushën e shëndetit, me institucionet arsimore dhe shëndetësore të mëposhtme: ▪ Hellenic Mediterranean University (Marrëveshje Nr.686 Prot.,Dt.01-06-2016) ▪ Drejtorisë Rajonale Vlorë të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (Marrëveshje Nr.997 Prot.,dt.17-06-2019)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

	▪ Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë (Marrëveshje Nr.68 prot., dt.07-10-2015). ▪ Drejtorisë së Spitalit Rajonal Fier (Marrëveshje Nr.221 prot., dt.10-10-2017). ▪ Spitalit Psikiatrik 'Ali Mihalit' Vlorë (Marrëveshje Nr.1127 prot., dt.17-06-2019). ▪ Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (Nr.2509 Prot.,dt.29-12-2017) ▪ Fh Gesundheit - Tirol Kliniken GmbH and Private University for Health Sciences, Medical Informatics and Technology – Austri.
Bibliotekë, numrin e titujve, numrin e posteve të leximit, e-library	UV vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e cila ndodhet në godinën A dhe një degë në godinën B. Të dyja sallat e bibliotekës janë të hapura për studentët e UV gjatë të gjithë orarit zyrtar të mësimi. Të dhënat për oraret e bibliotekës janë të disponueshme në faqen zyrtare univlora.edu.al. Biblioteka në godinën A ka sipërfaqe 250 m², me kapacitet 70 vende dhe me një numër librash prej 4930 volume, kurse biblioteka në godinën B ka një sipërfaqe 60 m² me kapacitet 30 vende dhe 1350 volume. Gjithashtu , sipas marrveshjes me Hellenic Mediterranean University – Greece, studentët e doktoratës së Fakultetit të Shëndetit do të kenë akses në bibliotekën online të këtij universiteti për kryerjen e studimeve revieë dhe research të literaturës për temën e dizertacionit. e-library: https://ulibrary.rash.al/ www.cobis.net www.cifl.net
Zyra për stafin akademik dhe ndihmës akademik	<i>Stafi akademik:</i> ▪ 1 zyrë për drejtuesen e departamentit ▪ 1 zyrë për stafin akademik ▪ 1 zyrë për koordinatoren e doktoratës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Stafi ndihmës-akademik:

- 1 zyrë për sekretarinë mësimore
- 1 zyrë për shërbimin ndaj studentëve

g) Analizë e tregut të punës

Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapjen /riorganizim në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.

Programi Doktoratë në Shkencat e Shëndetit, i propozuar nga Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë synon të realizohet në standartet më të larta bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ai mbështetet prej dy marrveshjeve specifike me Universitetin e Mjekësisë në Tiranë (lider në fushën e kërkimit në shëndetësi) dhe Hellenic Mediterranean University – Greqi. Ky bashkëpunim do të mundësojë:


- numër të mjaftueshëm udhëheqësish shkencorë në dispozicion,
- standarte të larta të Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore 'Doktor' dhe komisioneve të vlerësimit të punimit të doktoratës,
- zhvillimin e disa prej hallkave të kërkimit shkencor (research të literaturës, mbledhjen e të dhënave studimore gjatë praktikës klinike) pranë këtyre universiteteve.

Programi është i mirëstrukturuar për të rritur kompetencat e studentëve në të gjitha aspektet e fushës së kërkimit dhe është bazuar në eksperiencën e gjatë të Fakultetit të Shëndetit në formimin e kërkuesve të rinj në Master Shkencor dhe në përvojën disa vjetore të këtij fakulteti në organizimin e aktiviteteve shkencore dhe zhvillimin e projekteve kërkimore-shkencore të financuara.

Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit.

Aktualisht numri i pedagogëve me gradë shkencore është i limituar: në 2 universitetet e Jugut (Vlorë, Gjirokastrë) nga 46 personel akademik në fushën e shëndetit vetëm 16 janë me grada shkencore dhe 4 janë doktorata në proces. Pjesa tjetër prej 26 asistent-lektorësh nuk kanë diploma të ciklit të tretë të studimeve. Ata sigurisht angazhohen në veprimtaritë kërkimore-shkencore, të planifikuara prej departamenteve, por nuk kanë formim të mirëfilltë si kërkues.

Nga ana tjetër, numri i profesionistëve të shëndetit në rajonin e jug-perëndimit (zona nën administrimin e Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë) me formim doktoratë është jashtëzakonisht minimal: nga 90 mjekë dhe 260 infermierë, që operojnë në Spitalin e Fierit ka vetëm 5 Doktor Shkencash; ndërsa në Spitalin e Vlorës ka vetëm 1 të tillë nga rreth 300 veta personel mjekësor dhe infermieror që punojnë aty. Ndërkohë që në Shërbimin parësor kërkuesit shkencorë mungojnë tërësisht.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

I vetmi institucion që për momentin ofron doktorata në fushën e shëndetit është Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kuotat e të cilit janë tejet të pamjaftueshme për nevojat që kanë institucionet arsimore dhe shëndetësore.

Nevoja e përmbushur e tregut të punës që plotëson programi i ri/riorganizuar i propozuar nga IAL-ja.

Rritja e nivelit të potencialit kërkimor, në përputhje me kërkesat e tregut të shërbimeve shëndetësore, të pedagogëve të universiteteve dhe të personelit të institucioneve shëndetësore:

- do të rriste ndjeshëm kapacitetet akademike dhe kërkimore të stafit të këtyre institucioneve në përmbushje të standarteve të cilësisë të kërkuara nga ASCAL dhe Ministria e Shëndetësisë,
- do të rriste punësimin stabil me të ardhura më të larta të pedagogëve dhe personelit shëndetësor.
- do të përmbushte politikat kombëtare të zhvillimit të IAL në drejtim të kërkimit shkencor.

Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.


Pjesa më e madhe e këtyre studentëve do të jenë të punësuar si pedagogë dhe personel shëndetësor, pasi ndërkohë i kanë përfunduar ciklet e dyta të studimeve që u lejojnë punësimin. Studimet në ciklin e tretë do të ofronin atyre vetëm punësim stabil dhe me të ardhura më të larta.

Për ata studentë që nuk janë të punësuar apo që do të ishin të interesuar të ndryshonin vendin e punës pas diplomimit, Këshilltari akademik që mbulon edhe pjesën e këshillimit të karrierës ka gjithë kontaktet e duhura me IAL partnere brenda dhe jashtë vendit për të dhënë rekomandimet e nevojshme për punësim.

Punësimi potencial i Studentëve.

Në përfundim të Doktoratës në Shkenca Shëndetësore, kërkuesit e rinj do të kenë njohuri, vizion, aftësi dhe eksperiencë të mjaftueshme:

- Për tu punësuar si lektorë në IAL
- Për tu punësuar në Institucionet kërkimore-shkencore.
- Për të qenë pjesë e grupeve të punës në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Për të vazhduar punën në shërbimin shëndetësor me standarte më të larta dhe më të mirë-paguar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Marrëveshje/ kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësim eventual të studentëve pas diplomimit.

- Marrëveshje me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë
- Marrëveshje me Hellenic Mediterranean University, Greqi
- Marrëveshje me Fh Gesundheit - Tirol Kliniken GmbH and Private University for Health Sciences, Medical Informatics and Technology, Austri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

ANALIZA FINANCIARE

E HAPJES SË PROGRAMIT DOKTORATË NË SHKENCAT E SHËNDETIT

Formimi i kërkuesve shkencorë në ciklin e tretë të studimeve, (pasi ka mbi 10 vjet që formon kërkues të ciklit të dytë të studimeve - Master Shkencor në Shkenca Infermiore) është në vazhdim të traditës më të mirë akademike të Fakultetit të Shëndetit dhe nuk ndryshon thelbësisht nga diplomat aktuale që FSH ofron në Master Shkencor. Në këtë kontekst realizimi i këtij programi do të bëhet i mundur brenda infrastrukturës mbështetëse ekzistuese të FSH, megjithëse do të kenë një volum më të madh pune dhe një gamë më të gjerë kërkimore. Administrata aktuale e FSH (sekretaria mësimore, laborantët) është e mjaftueshme për mbështetjen e studentëve të pritshëm dhe nuk do të ketë nevojë për rekrutime të reja.

Kostot shtesë që do të nevojiten për realizimin e këtij programi studimi do të jenë kostot e pagesës së orëve mësimore (gjithsej 365 orë të pagueshme në total për të tre vitet e studimit) plus shpenzimet administrative. Përlllogaritja e sasisë së këtyre orëve bazohet në Udhëzimin e MASR Nr.29, dt.10-09-2018, pika 12, gërmat ç,g dhe gj.

Llogaritja e tarifës vjetore të studentit për programin Doktoratë në Shkencat e Shëndetit:

Nëse orët mësimore realizohen si mbingarkesë e pedagogëve Prof.Dr full-time, ose si pagesë e pedagogëve Prof.Dr part-time, kostoja do të rezultonte si më poshtë:

Kostoja e studimeve të Doktoratës për të treja vitet e studimit			
Lloji i aktiviteteve	Struktura financuese	Numri i orëve të pagueshme	Vlera totale e orëve që do të paguhet nga UV (1300L/ora për titullin Prof.Dr.)
Udhëheqës shkencor	UV	1 pedagog x 80 orë x 3 vjet	240 orë = 312000 L
Oponentë	UV	2 pedagogë x 25 orë	50 orë = 65000 L
Komisioni i vlerësimit të Doktoratës	UV	1 kryetar x 15 orë 4 anëtarë x 10 orë	55 orë = 71500 L
Konsultime / këshillim studentësh	UV = Koordinatori i Doktoratës	20000L/student	20000L
Formim teorik	UV	120 orë / 6 studentë	20 orë = 26000 L
Trajnime dhe kualifikime të vazhduara	Vet-financim	0	0
Studim literature online	Pa pagesë – nga marrveshjet me RASH dhe	0	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI'
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Kostoja e studimeve të Doktoratës për të treja vitet e studimit			
Lloji i aktiviteteve	Struktura financuese	Numri i orëve të pagueshme	Vlera totale e orëve që do të paguhet nga UV (1300L/ora për titullin Prof.Dr.)
	<i>Universitetet partnere</i>		
Ndjekje e praktikës profesionale	<i>Pa pagesë – nga marrveshjet me Shërbimet shëndetësore dhe Universitetet partnere</i>	0	0
Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi statistikor i tyre	Vet-financim	0	0
Publikimi i rezultateve të pjeshme të studimit.	Vet-financim	0	0
Shkrimi dhe printimi i Dizertacionit	Vet-financim	0	0
Shpenzime administrative	UV		105500 L
Totali maksimal i kostos së studentit Doktorant për UV			600000 L

Tarifa e programit	Vlera
Tarifa totale e programit për 3 vitet e studimit	600,000 L
Tarifa vjetore e studentit	600,000 L / 3 vjet = 200,000 L

Sipas skemës që paraqitet më sipër, kostot e programit Doktoratë në Shkencat e Shëndetit do të jenë tërësisht të vet-financueshme prej tarifës së këtij programi.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

DR.ELA PETO

